



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje Ushqimesh për fëmijët e Çerdhes, Bashkia Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
158840000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,082,255.83 (dy milion e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 41,645 (dyzet e një mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndrushuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndrushuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte "Procedurë e hapur e thjeshtuar", percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: *"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar....."*;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: *"Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare"*.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2024 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore ”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë, *do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit).* Ndërsa dokumentacioni provues, *do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime te ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se disponon ambient (ushqimore) në territorin e Bashkisë Kurbin (e verifikueshme në QKB).
- Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se disponon ambient të përshtatshëm për magazinimin e mallrave të kërkuara, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe ambientet plotësojnë kushtet higjieno sanitare konform kërkesave ligjore.
- Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.
- Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.
- Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se merr përsipër transportin e mallrave deri në ambientet e çerdhes në qytetin Laç duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.
- Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do levroje mallrat sipas kërkesave të Çerdhes dhe nese eshte e nevojshme per disa mallra duhet te marre persiper qe ti levroje cdo dite, pasi ushqimet jane per femije te vegjel dhe duhen sa me te fresketa.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK. Deklaratat e mësipërme janë kërkuar pasi janë të nevojshme për zbatimin e kontratës me sukses. Kemi kërkuar që OE fitues të vetëdeklarojë se disponon ambient (ushqimore) në territorin e Bashkisë Kurbin (e verifikueshme në QKB), pasi është e domosdoshme që OE të ketë ambient (ushqimore) në territorin e Bashkisë Kurbin, për arsye se disa ushqime konkretisht buka do të dërgohet cdo ditë nga OE tek Çerdhja e Qytetit. Gjithashtu mallrat si: fruta, perime do dërgohen sipas kërkesave të AK (cdo 2-3 herë në javë) për arsye se duhet të jenë sa më të frekëta. Duke parë se shume mallra duhen gati cdo ditë, për të

mos patur kosto shtesë është e domosdoshme që OE fitues të ketë ambient (ushqimore) brenda territorit të Bashkisë Kurbin.

Shënim: Ne zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.....etj. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.....”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kerkese në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jete kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.1147 Prot, datë 04.03.2025 “Kërkesë për Blerje Ushqimesh për fëmijët e Çerdhës” (e cila është bashkëlidhur dosjes).

Përlllogaritja e fondit limit është bërë nga “Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit”, referuar shkresën Nr.1147/1 Prot, datë 10.03.2025.

SPECIFIKIMET E USHQIMEVE:

- **Produktet kur të levrohen, duhet të jenë të shoqëruar me fletë analize për treguesit e sigurisë së cilësive, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.**
- Afati i lëvrimit **të mallit** do të jetë për 12 muaj duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës (Por në varësi të fëmijëve që frekuentojnë Çerdhën, kjo kontratë ka fuqi deri në ezaurimin e plotë të vlerës së saj).

Buke gruri: Të jetë me kore të lemuar, pa flluska, pa carje e pjesë të djegura dhe pa shkëputjen e saj nga tulli. Ngjyrë e kuqërremte. Tulli i njellojtë dhe i pjekur mirë, jo e ngjitshme, me konsistencë elastike që shtypja e lehtë të rikthehet në gjendjen e parë, jo e thermueshme dhe pa shtresa.

Era dhe shija e këndshme, jo e tharë, sasi 1 kg.

Buka të dergohet për konsum jo më parë se 3 ore nga koha e pjekjes.

Ambalazhimi të bëhet në letër, transporti të bëhet me mjete të pastra dhe të mbyllyra e të mbrojtura nga dëmtimet e faktoreve të tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Qumesht: Të jetë i freskët, i cilësisë së parë, të jetë i pastër dhe pa lëndë të huaj. Qumeshti për konsum të freskët detyrimisht pastërizohet në fabrikë sipas procesit teknologjik të përcaktuar. Të ketë shije dhe erë të këndshme, pa shije të hidhura e djegëse. Ambalazhimi në kuti, me ambalazh të sigurtë dhe të paketuar mirë. I etiketuar sipas standartit shtetëror.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit.

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit.

Data e skadimit.

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Tershere: Të jetë i paketuar, të cilësive së parë, ambalazhuar dhe etiketuar sipas standartit shtetëror.

Mish Pule: Të jetë mish pule cilesore, të etiketuar sipas standarteve shtetërore.

Mish vici : Të jetë i fresket, prodhim vendi. Çdo parti/karkasë mishi duhet të shoqërohet me certifikatë veterinare, e cila garanton sigurinë e produktit "mish" dhe me të cilën vërtetohet se, nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik. Te jete i shoqeruara me raport-analize nga organi kompetent.

Vaj ulliri: Vaj ulliri të jetë ekstra i virgjër me ambalazhim qelqi.
STAZH 102-87

Treguesit organo leptike:

- Pamja e jashtme te jete e kthjellet dhe pa asnjë turbullire.
- Ngjyra te jete e verdhe deri ne lehtësisht jeshile.
- Era dhe shija karakteristike te vajit te ullirit. Nuk duhet te përmbaje lende te huaja, te jete i rafinuar, aciditeti nuk duhet te kaloje 0.5 %.
- Ambalazhimi në shishe 0.5-1 litërshe qelqi ose plastike transparente me etikete ku te shënohen standartet. Nuk duhet të jetë i përzier me vajra te tjera dhe konservante.
- Treguesit e tjerë fiziko kimik sipas STAZH.

Markerimi:

- Emërtimi i prodhuesit.
- Emri i produktit .
- Pesha neto ose vëllimi i produktit.
- Data e prodhimit .
- Data e skadimit.
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Produkti duhet te jete i shoqeruar me raport analize te rregullt sipas legjislacionit ne fuqi.

Kripe: Te jete e bardhe, e imet, pa lageshtire, ambalazhuar sipas standarteve te tregut.

Kosi : Te jete i fresket, i cilesise se pare, te jete i paster dhe pa lende te huaj. Te kete shije dhe erën e kendshme, pa shije te hidhur e djegese. Ambalazhimi ne shishe plastike i mbyllur me kapak hermetik, dhe etiketuar sipas standartit shtetëror.

Veze: Bazuar ne STASH 1515-85 Lloji.VEZE PULE
KERKESAT CILESORE

- 1-Pamja e jashtme e paster dhe pa plasje.
- 2-Dhoma e ajrit (lartesia),mm, jo me shume se 9
- 3-E bardha e vezes e dendur e kulluar dhe e paster pa njolla gjaku (të kontrolluar ne ovoskop).
- 4- E verdha e vezes, Kompakte e ndodhur ne pozicionin qendror pak e levizshme .Lejohet devijim i vogel nga pozicioni qendror.
- 5-Era, Pa ere prishje dhe ere tjeter të huaj.
- 6-Masa.ne gr, jo me pak se 40.

AMBALAZHIMI

- Ambalazhimi në pikulina dhe arka kartoni, të etiketuar sipas standarteve shtetërore. Vezet ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 veze secila dhe në çdo kuti kartoni vendosen 12 cope kartona fole

-Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen. Emri i ndërmarrjes prodhuese, sasia, data e prodhimit.

Salc domate pa erza: Te jete cilesor pakeluar ne shishe qelqi.

Miell Gruri: Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja, i paster, i ambalazhuar në pako 1 kg. I etiketuar sipas standartit shtetëror.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit.
Emri i produktit .
Pesha neto ose vëllimi i produktit.
Data e prodhimit .
Data e skadimit.
Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Djathe i bardhe: Te jete prodhuar me qumesht lope i cilesise së pare, nga pamja e jashteme të ketë formen e plote, i paster dhe pa njolla e lende të huaj, i lemuar, i bute, pa dallim shtresash. Të ketë shije dhe ere të kendshme, pa shije të hidhur e djegese.

Djathe kackavall i grirë: Te jete cilesor, te kete shije dhe ere te kendshme, te jete i ambalazhuar dhe i etiketuar sipas standartit shtetëror.

Oriz: Të jetë me kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga levozhga dhe pa shenja myku ose prishje. Ambalazhimi 1 kg pakoja dhe i etiketuar sipas standartit shtetëror.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit.
Emri i produktit .
Pesha neto ose vëllimi i produktit.
Data e prodhimit .
Data e skadimit.
Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Biskota: Të jenë të paketuara të ndara në pako. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit.
Emri i produktit .
Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit .
Data e skadimit.
Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Sodë buke: Të jetë e cilësisë së parë, e stazhionuar, e ambalazhuar në pako 100 gr letre, emri i produktit, pesha neto ose vëllimi i produktit, data e prodhimit, data e skadimit.

Makarona: Të jenë në pako 500 gr të etiketuara sipas standartit shtetëror. Të ketë afatet e perdorimit. Të prodhuara nga brumë i përgatitur vetëm me miell gruri. Forma spageti, makarona të vogla. Të jenë me formë të rregullt, të plota me sipërfaqe të lëmuar. Mbas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qullohen, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë. Ngjyra e bardhë me nuancë ngjyrë të verdhë.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit.
Emri i produktit .
Pesha neto ose vëllimi i produktit.
Data e prodhimit .
Data e skadimit.
Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Trahana: Të jetë e paketuara, të cilësisë së parë, ambalazhuar dhe etiketuar sipas standartit shtetëror.

Sheqer: Të jetë i përbërë nga kristale të imta, pa copa të ngjeshura dhe lëndë të huaja. I etiketuar në pako 1 kg sipas standartit shtetëror.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit.
Emri i produktit .
Pesha neto ose vëllimi i produktit.
Data e prodhimit .
Data e skadimit.
Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Pure patate: Të jetë e paketuara, të cilësisë së parë, ambalazhuar dhe etiketuar sipas standartit shtetëror.

Reçel: Treguesit cilësorë të reçelit:

Pamja e jashtme:

1. Jo e shndritshme, e pasheqerosur, me sipërfaqe të njëllojtë, ku shënja myku dhe fermetimi nuk lejohen, pa pjesë të djegura, fletë fruit, fara dhe pjesë të fermetuara.
2. Ngjyra: E njëllojtë, karakteristike e frutave të përdorura të ziera me sheqer.

3. Shija dhe era. Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Treguesit kimik:

1. Lende reduktuese (sheqer invert) jo me shume se 0,1%.
2. Lagështia jo me shume se 0,16%.
3. Hiri jo me shume se 0,07%.

Uji natyral: Te jete i amballazhuar ne bidona 5 litra. Uji te jete i paster mikrobiologjikisht. Me etikete, ku te shenohen te gjithë perberesit kimike e kimiko-fizike qe duhet te permbaje.

Marketimi:

Emertimi i prodhuesit, emertimi i produktit, pesha neto, data e prodhimit data e skadimit, kushtet e veçanta te ruajtjes.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Frutat: Te jenë të cilësise së pare, të freskëta, të pastra, të pjekura me forme te rregullt, nuk lejohen demtime mekanike, demtime nga insektet, semundjet dhe lendet e huaja.

Perimet dhe zarzavate te tjera: Te jenë të cilësise së parë, të freskëta, të pastra pa përmbajtje dherash e kalbëzimesh, të amballazhuara në menyre që të mos dëmtohen gjatë transportit. Transporti i tyre të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore. Perimet e vyshkura nuk pranohen.

-Produktet me origjine shtazore te jene te shoqeruara me raport-analize nga organi kompetent.

Shenim: Nëse mallrat nuk jane sipas specifikimeve te mesiperme Komisioni nuk do i marrë në dorëzim.

Afatet e lëvrimit: 12 muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i proçedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

- | | |
|-----------------|------------------------------|
| 1. Pjeter Bushi | Kryetar (Përsoni përgjegjës) |
| 2. Rudolf Toma | Anëtar |
| 3. Aurora Buna | Anëtare |